

VENDIM
Nr. 448, datë 3.7.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 386, DATË 1.6.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E FUSHAVE DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT, QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR, DHE MBËSHTETJEN FINANCIARE TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER E TË STUDENTËVE, QË NDJEKIN KËTO PROGRAME NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja "c", e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c) Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar, të përcaktuara nga komisioni *ad hoc*, i ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, për çdo vit akademik, sipas fushave të studimit të miratuara në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi."

b) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

"4/1. Studenti përfitues sipas shkronjës "c", të pikës 2, të këtij vendimi, për vitin e parë të studimeve përfiton mbështetje financiare me bursë, në masën e pagës bazë minimale mujore, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas programeve që përbëjnë prioritet kombëtar për vitin akademik. Pas vitit të parë të studimeve, studenti përfiton mbështetje financiare me bursë deri në masën e pagës bazë minimale mujore, mbi bazën e arritjeve akademike, si më poshtë vijon:

a) me ruajtjen e notës mesatare mbi 8.00, përfiton 100% të masës së pagës minimale;

b) me ruajtjen e notës mesatare nga 6.5 deri në 8.00, përfiton 60% të masës së pagës minimale;

c) me ruajtjen e notës mesatare deri në 6.5, përfiton 30% të masës së pagës minimale.

Studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet akademike të vitit përkatës akademik për përlllogaritjen e notës mesatare vjetore."

c) Pika 6/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6/1. Për përcaktimin e programeve prioritare të studimit dhe kuotave të financimit për këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë për studentët përfitues sipas shkronjës "c", të pikës 2, të këtij vendimi, për çdo vit akademik, mbështetur në fondin e vitit përkatës buxhetor dhe në nevojat e vlerësimet periodike të IAL-së, si dhe prioritetet lokale, rajonale e kombëtare, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ngrihet komision *ad hoc*, i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, me përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, AKFAL-i dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Komisioni *ad hoc* përcakton, sipas fushave të përcaktuara në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, programet prioritare të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas nevojës për vitin akademik, dhe kuotat e financimit për këto programe, bazuar në buxhetin e miratuar të AKFAL-it, përpara fillimit të procesit të pranimit të studentëve në vitin akademik përkatës.

Programet prioritare dhe kuotat e financimit për çdo institucion publik të arsimit të lartë i dërgohen AKFAL-it nga komisioni *ad hoc*, i cili shpërndan për çdo IAL publike fondin e transferuar për këtë qëllim.

Përzgjedhja e studentëve përfitues, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të këtij vendimi, bëhet nga IAL-të publike për çdo program prioritar në bazë të renditjes, sipas notës mesatare në pranim, nëse numri i kërkuesve është më i madh se kuotat e miratuara.”.

ç) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. IAL-të, sipas këtij vendimi, depozitojnë tek AKFAL-i, çdo vit, listën e notave dhe vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të studentëve përfitues për vitin e parë dhe vijues të studimeve.”.

d) Shtojca nr. 1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga viti akademik 2024–2025 e në vijim.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

Fushat e studimit
Arsim (arsim/mësuesi)
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë (shkenca biologjike, shkenca kimike, shkenca fizike, matematikë dhe statistikë)
Bujqësi, pyje dhe peshkim (bujqësi, pyje, peshkim)
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim (minierë dhe industri nxjerrëse inxhinieri navale/navigacion)